




Republika e Kosovës



Komuna e Malishevës

Drejtoria për Administratë dhe Përsone

Zyra e Prokurimit

Nr 03/ 28

Datë : 26-04-2023.

KONTRATË PROKURIMI NR 23

62500-23-2305-1-2-1/C659

KUVENDI KOMUNAL MALISHEVE, (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në një të anë;
"METI PLAST " SH.P.K. me seli në Malishevë me nr.biznesi: 811437369 (në vazhdim
"Furnizues"), në anën tjetër, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për furnizimet e shënuara
me poshtë:

FURNIZIMI, MONTIMI I PERDEVE NË OBJEKTIN E RI TË KOMUNËS SË MALISHEVËS me numër identifikues:

Nr. i Prokurimit ¹	62500-23-2305-1-2-1
Nr i brendshëm	62500-23-015-1-2-1

Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kontratës do të jetë: FURNIZIMI, MONTIMI I PERDEVE NË OBJEKTIN E RI TË KOMUNËS SË MALISHEVËS.

Neni 2 Kushtet e dërgesës

2.1 Afati kohor për dorëzim do të jetë : 20 ditë nga koha e lëshimit të urdhër blerjes nga ana e Autoritetit Kontraktues.

2.2 Vendi i dorëzimit të furnizimit do të jetë : NË OBJEKTIN E RI TË KOMUNËS SË MALISHEVËS.

2.3 Inkotermi² i zbatueshëm do të jetë :

Neni 3 Origjina

3.1 Furnizuesi duhet të dorëzojë një certifikatë të origjinës së furnizimeve, më së voni atëherë kur e kërkon pranimin e përkohshëm të furnizimeve. Mosveprimi sipas këtij kushti mund të ketë si rezultat ndërprerjen e kontratës.

3.2 Origjina e mallrave do të përcaktohet sipas Kodit të Doganave të Bashkësisë Evropiane (Community Customs Code-) ose sipas marrëveshjeve ndërkombëtare të cilat i ka nënshkruar vendi në fjalë.

¹ Të raportohet në çdo dokument apo kërkesë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit

² Incoterms 2010 Oda Ekonomike Ndërkombëtare

Neni 4 Çmimi

4.1 Çmimi total i furnizimeve duhet të jetë: **18,270.00€**

(Tetëmbëdhjetë mijë e dyqind e shtatëdhjetë euro) Euro.

4.2 Çmimi i përmendur në Nenin 4.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Furnizuesit sipas kontratës.

4.3 Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve.

[Nëse disa artikuj iu nënshtrohen ndryshimeve]

Çmimet e artikujve që janë subjekt të rregullimit të çmimit janë subjekt i rregullimeve në vijim: [shëno indeksin ose burim tjetër të rregullimit të çmimeve]

4.4 Pagesat do të bëhen në pajtim me Kushtet e përgjithshme dhe/ose të Veçanta të kontratës.

Neni 5 Rendi i përparësisë i dokumenteve të kontratës

5.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

- (a) Kjo marrëveshje e kontratës;
- (b) Kushtet e Veçanta të Kontratës;
- (c) Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
- (d) Tenderi i Furnizuesit, duke përfshirë edhe Specifikimet Teknike;
- (e) Oferta financiare;
- (f) [shëno çdo dispozitë tjetër të dosjes së tenderit].

5.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

Neni 6 Komunikimet

6.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Furnizuesit nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të dërgohen me postë, faks, email ose të dorëzohen personalisht.



6.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimit të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimit të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.

6.3 Kudo që në kontratë parashikohet dhënia e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftimin e tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njoftoj", "vërtetojë", "miratoj" ose "vendosë" do të shenohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendim i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsye.

6.4 Kjo kontratë është e përgatitur në gjuhën shqipe ³ në tri origjinale, dy prej të cilave janë për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinale për Furnizuesin.

Për Autoritetin Kontraktues

Për Operatorin Ekonomik

Emri:	Nuhi Shalaj	Emri:	Arben Krasniqi
Pozita:	Menaxheri i Prokurimit	Pozita:	Drejtor
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data:	26.04.2023	Data:	26.04.2023
Vula:		Vula:	

³ Gjuha do të jetë gjuha e shfrytëzuar nga tenderuesit në këtë tender.

KUSHTET E VEÇANTA

Numri i kontratës: 62500-23-2305-1-2-1/C659

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës		Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK
Përshkrimi i nenit	Nr. Nenit	
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.
	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë : SHQIPE .
Siguria e ekzekutimit	9.1	10 % e vlerës së kontratës për 60 ditë nga data nënshkrimit të kontratës.
Programi i ekzekutimit	11	OE Furnizimin, montimin e perdeve në objektin e ri të Komunës së Malishevës duhet ta kryej në afatë prej 20 ditëve që nga dita e nënshkrimit të kontratës.
Menaxhimi i Kontrates	12	Menaxhimi i kontratës do ta bëjë zyrtari i DAP-së z.Milaim Kastrati i caktuar nga ZKA i AK-së. Menaxheri i kontratës është përgjegjës për mbikqyrjen e ekzekutimit të Furnizimin, montimin e perdeve në objektin e ri të Komunës së Malishevës gjatë tërë kohës, duke filluar që nga dita e parë e fillimit të furnizimit e deri në përfundim të kontratës. Menaxheri i projektit do të mbikqyrë OE gjatë tërë kohës sa zgjatë furnizimi duke filluar nga dita e parë e deri në përfundimin e kontratës përkatësisht ekzekutimin e kontratës. Qëllimi i mbikqyrjes është të kontrollojë cilësinë dhe sasinë e furnizimit. AK e ruan të drejten që t'ia ndërprej kontratën me OE për mos realizimin e kontratës në cilësi dhe sasinë në afatë dhe ne përputhje të plotë me specifikacionin e ofertës .
Pranimi përfundimtar		Pranimin përfundimtar të Furnizimin, montimin e perdeve në objektin e ri të Komunës së Malishevës do të bëhet nga një komision i caktuar nga ZKA i AK-së.
Tatimet dhe marrëveshjet doganore	13	Të gjitha i përkasin OE.

Cilësia e furnizimeve	18.2	Furnizimin, montimin e perdeve në objektin e ri të Komunës së Malishevës duhet të jetë në cilësi dhe sasi të kërkuar nga AK dhe në përputhëshmeri të plotë në specifikacionin e ofertës. Nëse furnizimi nuk kryhet në cilësi dhe sasi të kërkuar do të i kthehet OE dhe shpenzimet e bëra do të bien në llogari të OE.
Pagesa	20.1	<u>Pagesa do të bëhet në Euro.</u> Obligohet AK që pasi ta e pranon raportin e pranimi të Furnizimin, montimin e perdeve në objektin e ri të Komunës së Malishevës nga zyrtari z. Milaim Kastrati (menaxheri i kontratës) si dhe faturen nga OE të ia paguaj shumen sipas nenit 4 dhe 4.1 të kësaj kontrate. Pagesat OE do të i bëhen në bazë të raportit të menaxherit të kontratës ndërsa pagesa finale do të bëhet në bazë të raportit të menaxherit të Kontratës dhe raportit të një komisioni të caktuar nga ZKA i AK-së.
Dorëzimi	21.3	Vendi i dorëzimit të Furnizimin, montimin e perdeve do të jetë: Në objektin e ri të Komunës së Malishevës
Vonesat në ekzekutim	25	Nëse Operatori Ekonomik me përgjegjësinë e tij nuk arrin të kryej furnizimin brenda limiteve kohore të specifikuara në kontratë, Autoriteti Kontraktues, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0,25% në ditë të vlerës së furnizimeve të pa dorëzuara deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të kontratës.
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjes	31.2	Komisioni për ndërmjetësim pranë Ministris së Drejtësisë.
Zgjidhja e mosmarrëveshjes me procedure gjyqësore	32.1	a) Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet [Gjykata Themelore Prishtinë] në pajtim me ligjin në Kosovë.

Komuna e Malishevës
Drejtoria për Administratë të Përgjithëshme
Datë 21.02.2023

Specifikacioni i furnizimit dhe montimit të perdeve

Nr. Rend	Pershkrimi i furnizimit	Njësia matëse	Sasia	Gjimi	Totali
1	Furnizimi me Perde Shangrill dhe montimi	m2	390	43,00	16.770,00
2	Furnizimi me Shin per Perde dhe montimi	m L	150	10,00	1.500,00
TOTALI					18.270,00

